



Republika e Kosovës
Republika Kosovo –Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 45

Prishtinë, më 21.9.2016, ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Pal Lekaj, Xhevahire Izmaqi, Zafir Berisha dhe Shqipe Pantina.

Munguan: Jelena Bontiq, Alma Lama dhe Kujtim Paçaku.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Sadri Ferati, nënkryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2015;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2015;

Para se të fillohet me shqyrtimin e raportit, kryesuesi i Komisionit, Sadri Ferati, ia dha fjalën deputetes, **Shqipe Pantina**. Ajo propozoi që raporti të mos shqyrtohet, në mungesë të ministrit të Ministrisë së Administratës Publike, për arsye se raportin duhet ta prezantojë dhe ta mbrojë ministri, si dhe të përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të Komisionit për çështjet të cilat janë të përfshira në raport dhe për të cilat është përgjegjëse ministria.

Zafir Berisha, duke përkrahur diskutimin e znj. Shqipe Pantina, tha se edhe këtë shqyrtohet raporti, nuk mund të votohet pa e prezantuar hartuesi dhe se në paqartësitë e tij lidhur me raportin, duhet që dikush nga ministria të përgjigjet.

Pal Lekaj, tha se mosprezenca e përfaqësuesve të ministrisë për prezantimin e raportin, është injorancë totale ndaj Komisionit dhe është e paarsyeshme të diskutohet për raportin.

Xhevahire Izmaku, tha se nuk janë ftuar përfaqësuesit e ministrisë, sepse është menduar që raporti të shqyrtohet brenda Komisionit dhe në mbledhjen e radhës të ftohen përfaqësuesit e ministrisë, për të dhënë përgjigje në vërejtjet apo pyetjet e anëtarëve të Komisionit. Lidhur me raportin, ajo propozoi që të ftohet ministrinë mbledhjen e radhës.

Sadri Ferati, u pajtua me propozimet e diskutuesve dhe propozoi që mbledhja të mbahet të hënën, më 26 shtator 2016, në orën 11:00.

Konstatim—Komisioni unanimisht vendosi që mbledhja e radhës të mbahet në datën e propozuar, si dhe në mbledhje të ftohet ministri i Ministrisë së Administratës Publike.

3. Të ndryshme

Shqipe Pantina, njoftoi Komisionin për një tryezë, që do të mbahet në fillim të muajit tetor për monitorimin e Ligjit për OJQ-të, ku do të dëgjohen shqetësimet e komunitetit, mbi bazën e të cilave pastaj do të nxirren rekomandimet.

Sipas mediave, është kuptuar për krijimin e një grupi të punës për hartimin e statusit të asociacionit të komunave me shumicë serbe, dhe lidhur me këtë, ajo kërkoi të ftohet ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për raportim, duke theksuar se për çështjen në fjalë është anashkaluar Kuvendi.

Sadri Ferati, propozoi që për çështjen në fjalë, të ftohet ministrja për Dialog, znj. Edita Tahiri, ndërsa për çështje të tjera, çështjen e Ligjit për kufijtë administrativë të komunave, të ftohet edhe ministri i MAPL-së.

Pal Lekaj, tha se çfarëdo veprimi që merret jashtë Vendimit të Gjykatës Kushtetuese për çështjen në fjalë, përgjegjësia juridike bie mbi ata që e procedojnë.

Gjykata Kushtetuese ka qenë e qartë në çdo pikë të vendimit, se të gjitha nenet e marrëveshjes kanë qenë në frymën jokushtetuese. Në këtë kontekst, propozoi që të pyetet ministrja për Dialog, pse në Bruksel po bisedohet për kufijtë administrativë të komunave?

Konstatim - Komisioni unanimisht u pajtua me propozimet e sipërhënuara.

Mbledhja përfundoi në orën: 13:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Zenun Pajaziti